



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË  
KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIA DEVOLL, Z. FEZI SHEHOLLI NË ZBATIM TË LIGJIT  
NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,  
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 15.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për Kryetar Bashkia Devoll, z. Fezi Xheladin Sheholli në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 5, pika 4, gërma "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



**Nr . 397 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Devoll, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VËREN

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", kandidat i pavarur ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z. Fezi Xheladin Sheholli si kandidat për kryetar të bashkisë Devoll.

Gjithashtu z. Fezi Xheladin Sheholli në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, rezulton z. Fezi Xheladin Sheholli nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes dhe zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore, sipas së cilës rezulton se z. Fezi Xheladin Sheholli është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se dhënat e deklaruara nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015. Gjithashtu KQZ ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, gërma "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe pikës 5/1, 6 të nenit 9 të udhëzimit nr. 2, datë 29.01.2013 "Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve", KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për rregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Devoll, Qarku Korçë, kandidat i pavarur për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 5, pika 4, gërma "f", të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose



**Nr . 397 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Devoll, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

#### **VENDOSI:**

1. Njoftimin e KZAZ-së nr. 70 për vazhdimin e procedurave për rregjistrimin e kandidatit për kryetar Bashkia Devoll, Qarku Korçë, kandidat i pavarur për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr . 397 i vendimit Data 15.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit**

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar Bashkia Devoll, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.